



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

UNIVERZITETI I PRISHTINËS, FAKULTETI I ARTEVE

RAPORT I MONITORIMIT

11.05.2023, Prishtinë

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të AKA-së për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA-së;*
- *Ilirijana Ademaj Ahmeti, Zyrtare e Lartë për Vlerësim dhe Akreditim;*
- *Jonida Berisha, Praktikante në AKA.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 17.05.2023

Monitorimi është realizuar:

- a) në distancë
- b) me vizitë në terren me paralajmërim
- c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 17.05.2022

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Hazir Hazirin, dekan;*
- *Mehmet Behluli, prodekan;*
- *Genci Rezniqui, koordinator i cilësisë.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave dhe ushtrimeve;*
- *Intervista (diskutime) me dekan, prodekan dhe koordinator të cilësisë.*

2. Përshkrim i shkurtë i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 13:25, në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës.

Ekipi i AKA ka vizituar ambientet e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në kuadër të aktiviteteve monitoruese. Në këtë institucion, ekipi monitorues takoi dekanin e fakultetit zt. Hazir Hazirin, prodekanin zt. Mehmet Behluli dhe koordinatoren për cilësi zt. Genci Reznqi. Stafi i këtij institucioni ishte korrekt në bashkëpunim dhe ishin në dispozicion për të ofruar sqarime dhe përgjigje ndaj kërkesave të ekipit monitorues.

Ekipi monitorues fillimisht paraqiti kërkesë monitorim në sallat ku mbahej ligjëratat për programet të përzgjedhura nga ekipi monitorues me metodën e rastit.

Gjatë këtij aktivitetit, ekipi monitorues verifikoi mbarëvajtjen e mësimit disa nga sallat si në vijim:

- Salla në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Blerim Gjinovci në lëndën “Kamerë dhe fotografi”;
- Salla në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Astrit Salihu, në lëndën “Filozofi e Artit dhe Kulturës”;
- Salla në të cilën mbahej ushtrimet (shfaqje në teatër) me prof. Astrit Kabashi;
- Salla në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Agron Bytyqi, në lëndën “Pikturë”.

Ekipi monitorues konstatoi se në të gjitha ambientet e mësimit të prezantuara sipas orareve ishin prezent mësimsdhënësit dhe studentët në përjashtim të prof. Agron Bytyqi, i cili mungonte në ligjëratën e tij.

Në vazhdim të vizitës monitoruese, ekipi ka diskutuar me përfaqësuesit e fakultetit në lidhje me dëshmitë mbi vijueshmërinë e studentëve dhe mësimsdhënësve. Nga kjo ka konstatuar se sistemi elektronik për vijueshmërinë e studentëve dhe mësimsdhënësve për vitin akademik 2022/2023 nuk është funksional. Ekipi monitorues ka bashkëbiseduar edhe me studentë e Fakultetit të Arteve me të cilët janë shtjelluar çështje lidhur me organizimin e mësimit, ushtrimeve, pajisjeve, etj.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

1. Ekipi monitorues ka konstatuar se mbarëvajtja e ligjëratave ka qenë në përputhje me oraret e planifikuara në përjashtim të rastit të theksuar më sipër në këtë raport.

2. Ekipi monitorues ka konstatuar se oraret e ligjëratave nuk janë të publikuara në ambientet e Fakultetit të Arteve.

4. SHTOJCAT (dokumentet e mbledhura gjatë vizitës)

1. Listë e nënshkrimeve të mësimeve;
2. Listë e nënshkrimeve të studentëve;

Drejtori i AKA-s dhe Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së


Kryesues

NAIM GASHI  (Data)

Anëtar

Iliriana Ademi Ahmeti  (Data)

Anëtar

Jomida Beqisha Halkori  (Data)